



KB

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 7207 ProtVlorë, më 15.04 2026

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____, 2026

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB-NË NR. 98 DATË 27.11.2025 "PËR
MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE NIVELIT TË PAGAVE TË
BASHKISË, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE FUNKSIONEVE TË
DELEGUARA – 2026" TË NDRYSHUAR**

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 113, Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b të Kreut III, neni 54 pika ç, d dhe dh, të Kreut IX, neni 64 pika c të Kreut X, Ligjin nr. 35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera Financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", VKB-në nr. 98, datë 27.11.2025 "Për miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funkcioneve të deleguara - 2026" të ndryshuar dhe shkresat nr. 7194 prot. datë 15.04.2026 "Kërkesë për punonjës sezonal" dhe nr. 7200 prot. datë 15.04.2026 "Për organizimin, marrjen e personelit mbështetës në strehën e kafshëve endacake";

V E N D O S I:

1. Të bëhet ndryshimi në pikën 4 të VKB-së nr. 98, datë 27.11.2025, si më poshtë:

- Administrata e Bashkisë ishte 405– bëhet 427 punonjës

- 16 pozicione nga të cilët 8 do të shërbejnë për punonjës sezonalë si vrojtues plazhi dhe 8 punonjës për mirëmbajtjen e plazheve publike, gjatë periudhës së sezonit turistik.

- 6 pozicione do të shërbejnë si punonjës mbështetës në qendrën e strehimit të kafshëve.

2. Ndryshimet në fondin e pagave do të pasqyrohen në buxhetin e Bashkisë Vlorë 2026.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë Vlorë.

4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 55, pika 6.

KRYETAR

Brunilda Mersini

**ME URDHËR DELEGIMI
NËNKRYETAR**

Joljana Llanaj





REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 7207 prot.

Vlorë, më 15 04 2026

RELACION
PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR
DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKB-NË NR. 98 DATË 27.11.2025 “PËR
MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE NIVELIT TË PAGAVE TË
BASHKISË, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE FUNKSIONEVE TË
DELEGUARA – 2026” TË NDRYSHUAR

Të nderuar këshilltarë,

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b, të Kreut III, neni 54 pika ç dhe dh, Kreu IX, neni 64, pika a, b, c, ç dhe d të Kreut X, është kompetencë e Këshillit Bashkiak miratimi i numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë, si dhe të njësisve e institucioneve buxhetore në varësi të Bashkisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në lidhje me projektvendimin e paraqitur në këtë mbledhje të Këshillit Bashkiak, ju informojmë se:

Për pikën 1. Të bëhet ndryshimi në pikën 4 të VKB-së nr. 98, datë 27.11.2025, si më poshtë:

- Administrata e Bashkisë ishte 405 – bëhet 427 punonjës
- 16 pozicione nga të cilët 8 do të shërbejnë për punonjës sezonalë si vrojtues plazhi dhe 8 punonjës për mirëmbajtjen e plazheve publike, gjatë periudhës së sezonit turistik.
- 6 pozicione do të shërbejnë si punonjës mbështetës në qendrën e strehimit të kafshëve.

Bazuar në VKM-në nr. 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores “për kushtet dhe kriteret eushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” e ndryshuar dhe në shkresën nr. 7194 prot. datë 15.04.2026 “Kërkesë për punonjës sezonal” të Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, në të cilën kërkohen 16 pozicione do të shërbejnë për punonjës sezonalë si vrojtues plazhi dhe 8 punonjës për mirëmbajtjen e plazheve publike, gjatë periudhës së sezonit turistik, kërkohet nga Këshilli Bashkiak miratimin e shtimit të këtyre pozicioneve në numrin total të punonjësve të Bashkisë Vlorë. Shtimi i pozicioneve ka si qëllim garantimin e sigurisë së pushuesve në plazhet publike dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike në këto plazhe.

Bazuar në Ligjin nr. 10 465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe shkresën nr. 7200 prot. datë 15.04.2026 “Për organizimin, marrjen e personelit mbështetës në strehën e kafshëve endacake”, Sektori i mbrojtjes së konsumatorit dhe mjedisit ka kërkuar të shtohen 6 pozicione për punonjës mbështetës në qendrën strehimit të kafshëve endacake. Këto pozicione janë në funksion të përmirësimit të shërbimit ndaj komunitetit dhe respektimit të standardeve për trajtimin e kafshëve endacake.

Ju faleminderit!

KRYETAR

Brunilda Mersini

**ME URDHËR DELEGIMI
NËNKRYETAR**

Joljana Llanaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Nr. 7194 prot.

Vlorë, më 15.04.2026

Lënda: Kërkesë për punonjës sezonal

**DREJTORISË SË BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË FINANCËS, BUXHETIT DHE KONTABILITETIT**

Në zbatim të VKM nr. 649 datë 16.10.2024 "Për Miratimin e Rregullores "Për Kushtet dhe Kriteret e Ushtrimit të Veprimtarisë së Stacionit të Plazhit" e ndryshuar me VKM nr. 60 datë 28.01.2026, duke qënë se Njësia e Vetëqeverisjes Vendore menaxhon hapësirat publike plazhe, duke qënë se vija bregdetare është e konsiderueshme prej 18176 ml, kërkojmë nga ana juaj në total 16 punonjës sezonal ku:

- 8 punonjës sezonal, gjatë sezonit turistik do të kryejnë mirëmbajtjen e hapësirës publike të plazheve
- 8 vrojtues plazhi sezonal, gjatë sezonit turistik

Referuar nenit 8 të VKM-së nr. 649 datë 16.10.2024, ku citohet se duhet të plotësohen kushtet minimale të stacionit të plazhit, sipas tipologjisë së plazhit. Punonjësit që do të shërbejnë pranë stacioneve të plazhit duhet të kenë uniformë dalluese si dhe detyrimin të mirëmbajnë dhe të parandalojnë ndotjen e hapësirës së plazhit që është në përdorim nëpërmjet shërbimit për pastrimin dhe mirëmbajtjen e stacionit të plazhit çdo ditë, në mëngjes dhe në mbrëmje pas mbylljes së plazhit.

Gjithashtu bazuar në nenin 9 të VKM- së nr. 649/2024 "Kërkesat për sigurinë në stacionet e plazhit", pika 3 citohet se: "Të gjitha stacionet e plazhit duhet të garantojnë shërbimin me vrojtues plazhi përgjatë gjithë kohës që ushtrohet aktiviteti, edhe stacionet e plazhit me vijë lineare bregdetare nën 80 (tetëdhjetë) m kanë detyrimin të kenë vrojtues plazhi.

Ky personel është i nevojshëm për garantimin e funksionimit normal të sezonit turistik për vitin 2026.

Lutemi për shqyrtimin dhe miratimin e kësaj kërkesë.

DREJTOR

Bruna Bisholla



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETIVE
SEKTORI I MBROJTJES SË KONSUMATORIT DHE MJEDISIT

Nr. 7200 prot.

Vlorë, më 15.04 2026

Lënda: Për organizimin, marrjen e personelit mbështetës në strehën e Kafshëve endacake.

DREJTORISË SË BURIMEVE NJERËZORE

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007, “Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmave në Mjedis”, i ndryshuar me ligjin nr. 50/2023, në funksion të detyrave për monitorimin e ndotjes akustike në territorin e Bashkisë Vlorë j’u informojmë se:

Në kuadër të funksionimit të rregullt dhe garantimit të standardeve të duhura për mirëqenien e kafshëve endacake, paraqitet nevoja për organizimin e një strukture të dedikuar të personelit mbështetës pranë strehës së kafshëve.

Bazuar në volumet e punës, shërbimet që duhet të ofrohen dhe kërkesat ligjore për mirëmbajtjen dhe trajtimin e kafshëve, rezulton se është e domosdoshme punësimi i 6 (gjashtë) punëtorëve mbështetës.

Arsyetimi i nevojës për personel: Punëtorët mbështetës do të jenë përgjegjës për realizimin e proceseve kryesore operative të strehës, konkretisht:

Kapjen dhe grumbullimin e kafshëve endacake në territor;

Transportimin e tyre në kushte të sigurta dhe humane drejt strehës;

Ushqimin e përditshëm sipas standardeve të përcaktuara;

Pastrimin dhe dezinfektimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme;

Kujdesin bazë për mirëqenien dhe higjienën e kafshëve.

Organizimi i punës: Duke qenë se streha funksionon në mënyrë të vazhdueshme, kërkohet mbulim me shërbim 7 ditë në javë, për të garantuar:

Ushqimin e rregullt të kafshëve çdo ditë;

Mirëmbajtjen e kushteve higjieno-sanitare;

Ndërhyrje të menjëhershme në rast emergjencash.

Për këtë arsye, personeli do të organizohet në turne pune, duke siguruar funksionim të pandërprerë të shërbimit dhe shpërndarje efikase të ngarkesës së punës.

Punësimi i 6 punëtorëve mbështetës është i domosdoshëm për garantimin e funksionimit normal të strehës, përmbushjen e standardeve të mirëqenies së kafshëve dhe ofrimin e një shërbimi cilësor ndaj komunitetit.

Ky organizim siguron menaxhim efikas, kushte të përshtatshme higjeno-sanitare dhe trajtim dinjitoz të kafshëve endacake.

DREJTOR
Bruna Bisholla

